



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 41-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28.07.2025, në sallën numër 2 kati i 3-të, në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Skender Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj, anëtare
3. Shahadije Bikliqi-Dragaçina, anëtare
4. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
5. Enver Kryeziu, anëtar
6. Zoran Cirkovic, anëtar
7. Slavisa Trajkovic, anëtar
8. Olga Gucic, anëtare
9. Idajet Garip, anëtar

Të tjerë prezent

1. Visar Kozhani, zyrtar i lartë i buxhetit
2. Përfaqësues të OSBE-së dhe UNMIK-ut
3. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë me kohë dhe e lexoi në vazhdim:

R E N D I T E

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e 40-të
2. Informatë, nga drejtorati për buxhet, rreth Buxhetit 2026-2028, në veçanti për vendet ku jetojnë komunitetet jo shumicë.
3. Të ndryshme

I

Aprovimi i Ekstraktit nga mbledhja 40-të e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje apo plotësime të ekstraktit nga mbledhja 40-të e Komitetit për Komunitete?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht aprovoi të njëjtin.

II

Informatë, nga drejtorati për buxhet, rreth Buxhetit 2026-2028, në veçanti për vendet ku jetojnë komunitetet jo shumicë

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Visar Kozhanit zyrtar i lartë i buxhetit, i cili njoftoi në pika të shkurtëra rreth Buxhetit 2026-2028. Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin.

Zoran Cirkovic, tha se unë kam marr pjesë në dëgjimet buxhetore në fshatin Grackë dhe kam ngritur kërkesën e banorëve të fshatit mirëpo mesa kam parë nuk është e përfshirë në buxhet, kërkesa.

Visar Kozhani, tha se mesa e di unë në fshatin Grackë është e paraparë asfaltimi i rrugëve në buxhet.

Shahadije Bikliqi-Dragaçina, tha se e kam një vërejtje për drejtorinë e buxhetit për shkak se nuk po bëhet specifikimi se cilat rrugë do të asfaltohen në qytet apo fshatra.

Visar Kozhani, tha se nuk na lejon ministria që me pas përshkrim të gjatë për projektet e caktuara.

Pasi diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën në vazhdim.

III

Të ndryshme

Skender Bikliqi, tha se unë do ta ngris edhe njëherë çështjen e pagesave të mëditjeve për anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Zoran Cirkovic, tha se ne me datën 23 korrik e kemi pas përvjetorin e vrasjes së disa të rinjëve dhe i falënderoj institucionet e Komunës të cilët na kanë përkrahur në mënyrë më të mirë të mundshme po ashtu i falënderojmë edhe institucionet e tjera për bashkëpunimin që kemi pas.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 13⁵⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi